



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

8 Qershor, 2018

Të Dashur Prindër dhe Miq të Shkollës Mayfair:

Faleminderit për pjesëmarrjen në takimin me zyrtarët e Drejtorise Arsimore të Filadelfias ditën e Enjte, 24 Maj, dhe për emailin tuaj të fundit që përshkruani shqetësimet tuaja lidhur lëvizjen e kopshtit dhe klasat e para në shkollën Austin Meehan. Dr. Hite na ka kërkuar që t'u përgjigjemi shqetësimeve tuaja.

Siç jeni në dijeni, kjo pjesë e qytetit po rritet me shpejtësi dhe ne do të ndërtojmë një shkollë të re për të përballuar rritjen, megjithatë, gjithashtu duhet t'ju sigurojmë se ka vend për çdo nxënës për të mësuar në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm në Mayfair. Regjistrimi i 1,902 studentëve për vitin e ardhshëm e bën të pamundur që t'i shërbejmë të gjithë nxënësve në Mayfair në një ndërtesë.

Ne e kuptojmë shqetësimin tuaj për lëvizjen e kopshtit dhe klasave të para nga Mayfair në Meehan ndërkohe që po ndërtohet një shkollë e re, ne duam të ndajmë me ju vendimin në lidhje me veprimet që po bën Drejtoria Arsimore për të siguruar që ndërtesa të jete gati për ditën e parë shkollës.

- Nga data 13 qershor deri 20 gusht 2018, rinovimet në Meehan do të krijojnë ambiente mikpritëse dhe të rehatshme për nxënësit e Mayfair. Këto rinovime përfshijnë:
- krijimi i hyrjes së veçante për programin e Mayfair;
- ndriçim i ri LED me efikasitet të energjisë në klasat dhe korridoret;
- lyerjen e të gjitha klasave;
- Riparimi i pajisjeve në klasa për të siguruar ajrin e freskët, ngrohjen dhe ftohjen;
- Ndërtimi i banjove të reja për fëmijët e vegjël;
- instalimi i dritareve të reja për të lejuar dritën natyrore të hyjë në klasë;
- Riparime në dyert dhe dyshemete e klasave sipas nevojës.

Riparimet do të bëhen në përputhje me kriteret e rekomanduara nga Drejtori i Shkencës së Mjedisit dhe Sigurisë së Shëndetit në Punë të Federatës së Mësuesve të Filadelfias i Shkencës dhe Shëndetit, Jerry Roseman, bazuar në një vëzhgim që u bë më 30 Maj.

Këto investime janë një shtesë e punës së rëndësishme që është bërë në Meehan gjatë viteve të fundit. Që nga 1 korriku i vitit 2015 Departamenti i Mirëmbajtjes së Drejtorise Aresimore ka përfunduar 748 punime, që arrijnë më shumë se 2,792 orë pune me një kosto prej 259,292 dollarë në Meehan. Riparimet e kësaj vere do të bëhen në sistemin HVAC që sistemi të funksionojë 100% për ngrohje dhe ftohje. Së fundmi, raporti i vlerësimit të gjendjes së objektit të Meehan (FCA) thotë se "ka numër të mjaftueshëm të pajisjeve në klasa, zyra, korridore, dhe zona të tjera në të gjithë ndërtesën. "Kjo do të thotë se ne do të jemi në gjendje të mbështesim nevojat e teknologjisë së programit Mayfair në Meehan me konfigurimin e tanishëm elektrik.

Ne gjithashtu jemi në dijeni për shqetësimet tuaja që fëmijët e vegjël janë në të njëjtën ndërtesë me nxënësit më të rritur. Ne do të kemi një sistem që do të sigurojë që fëmijët e vegjël të jenë të veçuar nga fëmijët më të rritur, ashtu siç bëjmë në të gjitha shkollat tona K - 8. Për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të rregullt në Mayfair ne jemi përkushtuar:

- * Personeli i programit Mayfair do të ketë Z/drejtor, këshilltar, infermiere dhe dy police shkolle të devotshëm.

- * fëmijët e vegjël do të hanë në kohë të ndryshme nga fëmijët më të rritur.

- * mobilje që janë të përshtatshme për fëmijët e vegjël do të sillen nga Mayfair në Meehan;

- * të njëjtat materiale mësimore dhe mjetet e teknologjisë që janë në Mayfair do të jenë në Meehan.

Ne do të komunikojmë rregullisht për progresin tonë gjatë verës dhe do të kemi një mbledhje me prindërit para fillimit të shkollës. Përveç kësaj, shkolla do të jetë në pritje të takimeve të grupeve të vogla në mënyrë që t'ju informojmë planet tona dhe të adresojmë çdo shqetësim që do të dalë. Drejtori i shkollës do t'ju njoftojë në lidhje me datat dhe kohën e këtyre takimeve.

Sinqerisht,



Sawn Bird, Ed.D

Shefi i shkollave



Danielle Floyd

Zyrtar i lartë operativ

c: William R.Hite, Jr.Ed.D.Superintendent

Drejtori, Guy Lowery

Kryetari, Mary A.Jackon

Këshilltar, Bobby Henon